

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istog Municipality of Istog
	Nr. 11-101/20	Dt.09.10.2020	

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 18, Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 neni 21,22,44 dhe 84 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), neni 17 pika d/, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit administrativ të MMPH -së nr. 06/2017 të dt 23.05.2017 për shqyrtimin e kërkesës për Kushtet e ndërtimit dhe Lejës së ndërtimit si dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. 11-351-25553 të datës 26.08.2020, të Abi Petroll përfaqësuar nga Rexhë Hajraj nga Klina, për lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit afarist Pikë Karburanti me objekte përcjellëse bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të Istogut aprovuar me datë 27.06.2019, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, në procedurë administrative, merr këtë:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	"ABI PETROL" - Rexhë Hajraj		
Adresa:	Klinë		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i Projektit:	Pikë Karburanti me objekte përcjellëse P+0		
Emri i Projektuesit:	Fduard Zikolli BI		
Adresa:	Gurrakoc		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Zona(t) Kadastrale: Llukafcë i Thatë	Nr. i parcelave kadastrale: nr. 00138-2 ZK Llukafcë i Thatë.	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input type="checkbox"/>	Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: Pikë Karburanti me objekte përcjellëse P+0	

Me këtë vendim, poseduesit të Lejes Ndërtimore “Abi Petrol” përfaqësuar nga Rexhë Hajraj i lejohe ndërtimi i objektit afarist Pikë Karburanti me objekte përcjellëse P+0.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë se saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese ne vendndertim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes se ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me te gjitha faza për nevoja te realizimit te ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollat e miratuara te nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi "Abi Petrol" përfaqësuar nga Rexhë Hajraj ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit afarist Pikë Karburanti me objekte përcjellëse P+0 në Llukafcë të Thatë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.05/L-31 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Kushtet Ndërtimore (aplikohet)
- Vendimi për Pëlqim Mjedisor (aplikohet)
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri (aplikohet)
- Elaborati Gjeomekanik (nuk aplikohet)
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Tri kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e II-te
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtoni, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror - MMPH.

I dorëzohet: Investitorit, Drejtorisë për Inspeksion ,Kësaj Drejtorie dhe QSHQ për arkivim.

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS NË ISTOGUT,

Planer Urban
ark. Krustem Gashi i.d.

Planer Urban
ark. Rexhep Blakaj i.d.

DREJTOR
Jashar Blakaj i.d.n.

